



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
PROGRAMI I FONDIT TË EKSELENCËS

NJOFTIM
PËR
HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR FONDIN E EKSELENCËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2018 - 2019.

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 16.07.2014 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)” dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 16, datë 01.08.2014 “Për përcaktimin e kritereve, masës dhe procedurave për përfituesit nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore”, i ndryshuar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall hapjen e procedurave të aplikimit për Fondin e Ekselencës për vitin akademik 2018-2019.

Dokumentacioni i aplikimit, kriteret dhe procedurat mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e kandidatëve janë të parashikuara në aktet nënligjore të sipërcituara, si dhe i gjeni në mënyrë më të detajuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, rubrika “**Fondi i Ekselencës**”.

Aplikimet do të jenë individuale dhe klasifikimi i kandidatëve do të jetë transparent.

Aplikimet, për kandidatët që ndjekin vitin e parë të studimeve për këtë vit akademik, do të ndahen në dy faza, për fazën e parë afati i dorëzimit të dokumenteve është nga data **1 Mars - 30 Prill 2018** dhe faza e dytë nga data **1 Gusht - 30 Shtator 2018**.

Aplikimet për kandidatët që do të ndjekin vitin e dytë apo pas tij të studimeve, të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar nga data **1 - 31 Korrik 2018 ose 1 Shtator - 15 Tetor 2018**.

Dokumentet dërgohen me postë në adresën:

Fondi i Ekselencës
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Rr. Durrësit, nr. 23
ALB-1001-TIRANA

Për çdo informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni me E-mail në adresën elektronike:
fondi.ekselenca@arsimi.gov.al